



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____ . ____ .2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr._____, datë____/____/2026

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN E BASHKISË
ROSKOVEC DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR RREGULLIMIN E
LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në institucionin e Bashkisë Roskovec,

VËREJ SE:

Me urdhërin nr. 97 (811 prot.), datë 27.10.2025, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Roskovec”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 891/1 prot., datë 27.10.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Roskovec me shkresën nr. 891/2 Prot., datë 27.10.2025, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Roskovec”*.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Roskovec, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se: *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 34 prot., datë 8.1.2026, të Komisionerit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, nuk ka paraqitur observacione brenda afatit 5 ditor të vendosur nga Komisioneri.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri vlerësoi si të rëndësishme, për të dhënë disa orientime në lidhje me procesin e ndërtimit të strukturës dhe organigramës së institucionit, duke e analizuar në mënyrë të hollësishme skemën e strukturës dhe në përfundim ka lënë detyra konkrete në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, bazuar në Udhëzuesit e Komisionerit:

- nr.1082 prot., datë 14.12.2021 *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2022”*;
- nr. 654, datë 02.10.2024, *“Udhëzues në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në strukturën organizative të institucioneve të administratës vendore dhe transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit të institucionit”*,

të cilët janë akte rregullative, që kanë dalë për të siguruar aplikimin e standardeve më të mira në ndërtimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në njësitë e vetqeverisjes vendore, nëpërmjet një vlerësimi real të pozicioneve të punës që e përbëjnë aktualisht skemën e administrimit të shërbimit civil, në referencë të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që

rregullojnë këtë aspekt, me qëllim që të përcaktohet me saktësi raporti i tyre me shërbimin civil, e për pasojë një strukturë ekonomike, efiçente dhe efektive.

E rëndësishme është të theksohet se nga ana e institucionit është bërë përpjekje për të zbatuar orientimet e dhëna nga Komisioneri në udhëzimin e tij, si edhe në shkresat orientuese dërguar institucionit me nr. 199/1 datë 06.04.2022 dhe nr. 288 datë 26.04.2024, në drejtim të respektimit të standarteve numerike dhe të linjës hierarkike administrative, por ende nuk është finalizuar procesi i vlerësimit/rivlerësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil.

Gjatë procesit të verifikimit të dokumentacionit në këtë subjekt, janë vërejtur disa mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të trajtuara me hollësi në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- ✓ Nuk është zhvilluar asnjë procedurë rekrutimi, në zbatim të planit të rekrutimit edhe pse janë publikuar si vende të lira 28 pozicione, nga të cilat nuk është zhvilluar asnjë procedurë konkurrimi, për faktin se nuk janë paraqitur kandidatë të interesuar;
- ✓ referenca ligjore e përdorur në disa raste që kanë lidhje me procesin e rekrutimit është e gabuar;
- ✓ nuk është bërë publikimi i procedurave për grup pozicionesh, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta;
- ✓ nuk është ngritur Komiteti i Përhershëm të Pranimi;
- ✓ në 35 raste, konstatohet se janë emëruar punonjës në pozicione pune që i përkasin shërbimit civil, duke mos respektuar kërkesat e ligjit dhe procedurat që duhet të aplikohen për institutin e rekrutimit.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara më sipër, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Roskovec, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
2. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, subjektet e ngarkuara prej ligjit, ndër të cilat Komiteti i Vlerësimit, analisti i punës, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt për pozicionet e vlerësuara, duhet të finalizojnë procesin e nisur për vlerësimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbajtje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit dhe përshkrimet e rishikuara të punës, duhet të dërgohen pranë Komisionerit në përfundim të afatit të paralajmërimit.

3. Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, duhet të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë, (*relacion apo memo*) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.
4. Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë të hartohet dhe miratohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil për vitin 2026, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.

5. Pasi të kryhen të gjitha detyrat që janë lënë në pikat 2; 3 dhe 4 të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Roskovec, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil dhe të rregullojë pasojat, duke i shpallur pozicionet e lira pranë AKPA-së, për tu plotësuar në përputhje me ligjin. Në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni duhet të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimi në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:

✓ **Pozicione pune në nivelin e kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese:**

- Eltona Cepele, emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Auditit të Brendshëm”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, nëpërmjet aktit (nr.59/2 prot.,) datë 16.01.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë,
- Nertila Pelivani, emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Integrimi European”, në Njësinë e Integritimit European, nëpërmjet aktit nr.184 (nr.8449 prot.,) datë 6.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë,
- Elsa Protoduari, emëruar në pozicionin “Përgjegjëse”, në Sektorin e Monitorimit të Kontratave, nëpërmjet aktit nr.165 (8318 prot.,), datë 1.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Durim Cjapi, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, nëpërmjet aktit nr.10 (188 prot.,), datë 14.1.2023 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Sara Kuka, emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Çështjeve Juridike” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, nëpërmjet aktit nr.114 (5560 prot.,), datë 15.9.2023 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Irena Gjata, emëruar në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit Sekretari-Arkivit”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, nëpërmjet aktit nr.321/2 prot., datë 20.1.2020 “Për ndryshim pozicioni” të Kryetarit të Bashkisë.
- Samuela Plaka, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Lejeve të Ndërtimit”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nëpërmjet aktit nr.106 (5561 prot.,), datë 18.7.2024 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Orgesa Hoxha, emëruar në pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë Ekonomike, nëpërmjet aktit nr.180, (8447 prot.,) datë 6.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë;

- Eneida Hoxha, emëruar në pozicionin “Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nëpërmjet nr.181 (nr.6373 prot.,) datë 20.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë,
- Kristina Gllava, emëruar në pozicionin “Drejtor i Teknologjisë së Informacionit, dhe Zyrës me një ndalesë” nëpërmjet aktit nr.169 (247/1 prot.,) datë 1.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë;
- Enerida Kuqo, emëruar në pozicionin “Drejtor i Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë” nëpërmjet aktit nr.41, (475 prot.,) datë 21.01.2025 “Për ndryshim pozicioni”, të Kryetarit të Bashkisë;

✓ **Pozicione në kategorinë ekzekutive:**

- Armida Profka, emëruar në pozicionin “Specialist për Politikën e Strehimit Social” në Drejtorinë e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë, nëpërmjet aktit nr.76 (1684 prot.,) datë 28.02.2025 “Për ndryshim pozicioni Përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë;
- Haxhire Sopiku, emëruar në pozicionin “Specialist i Auditit të Brendshëm”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, nëpërmjet aktit nr.397, (397 prot.,) datë 20.01.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë;
- Franklin Goga, emëruar në pozicionin “Specialist i Auditit të Brendshëm”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, nëpërmjet aktit nr.56 (888 prot.,) datë 03.02.2025 “Për Ndryshim Pozicioni”, të Kryetarit të Bashkisë.
- Eriselda Zekaj, emëruar në pozicionin “Specialiste për shkrimin e projekteve” në Drejtorinë e Integrimit Europian, nëpërmjet aktit nr.40 (474 prot.,) datë 21.01.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë.
- Ulpjana Blido, emëruar në pozicionin “Specialiste për shkrimin e Projekteve”, në Sektorin e Integrimit Europian, nëpërmjet nr.181 (nr.8448 prot.,) datë 6.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht”, të Kryetarit të Bashkisë,
- Nikolin Myrto, emëruar në pozicionin “Specialist për Zbatimin e Projekteve të Huaja, në Drejtorinë e Integrimit Europian nëpërmjet aktit nr.29 (315 prot.,) datë 16.01.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Aldi Hoxha, emëruar në pozicionin “Specialist për Ndjekjen e Investimeve” në Sektorin e Monitorimit dhe Zbatimit të Kontratave, nëpërmjet aktit nr.168 (8321 prot.,) datë 1.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Rezarta Blido, emëruar në pozicionin “Specialist mjedisi” në Sektorin e Planifikimit dhe Lejeve të Ndërtimit, nëpërmjet aktit nr.145 (9823 prot.,) datë 20.12.2024 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Borana Toli, emëruar në pozicionin “Specialist për Menaxhimin Pronash” në Sektorin e Menaxhimit të Pronave dhe Legalizimeve, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, nëpërmjet aktit nr.45 (658 prot.,) datë 27.1.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Lyter Toro, emëruar në pozicionin “Specialist për Menaxhimin Pronash” në Sektorin e Menaxhimit të Pronave dhe Legalizimeve, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të

Territorit, Mjedisit dhe Pronës, nëpërmjet aktit nr.162 (8315 prot.,) datë 1.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.

- Ana Kuqo, emëruar në pozicionin “*Specialist për Vullnetarizmin, Diasporën, Migracionin dhe Rininë*”, në Drejtorinë e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë, nëpërmjet aktit nr.170 (241/1 prot.,) datë 1.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Uljan Apostoli, emëruar në pozicionin “*Specialist për Diasporën dhe Turizmin*”, në Drejtorinë e Politikave Ekonomike dhe Promovimit të Bashkisë, nëpërmjet aktit nr.171 (317/1 prot.,) datë 1.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Xhuljana Duka, emëruar në pozicionin “*Specialist për Politikën e Strehimit Social*” në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike nëpërmjet aktit nr.77 (313 prot.,) datë 16.1.2025 “Për ndryshim pozicioni” të Kryetarit të Bashkisë.
- Klevi Hazizi, emëruar në pozicionin “*Specialist Finance*” në Drejtorinë Ekonomike, nëpërmjet aktit nr.198 (8830 prot.,) datë 20.10.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Naile Yzeiri, emëruar në pozicionin “*Specialist Për Prokurimet Publike*”, në Drejtorinë e Prokurimeve dhe Zbatueshmërisë së Investimeve, nëpërmjet aktit nr. 44 (1316 prot.,) datë 28.02.2023 “Për emërim të Përkohshëm” të Kryetarit të Bashkisë.
- Dionis Murataj, emëruar në pozicionin “*Specialist Për Prokurimet Publike*”, në Drejtorinë e Prokurimeve dhe Zbatueshmërisë së Investimeve, nëpërmjet aktit nr. 107 (5563 prot.,) datë 18.7.2024 “Për emërim të Përkohshëm” të Kryetarit të Bashkisë.
- Graciela Braho, emëruar në pozicionin “*Specialist për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, nëpërmjet aktit nr. 136 (8982 prot.,) datë 4.10.2022 “Për ndryshim pozicioni” të Kryetarit të Bashkisë.
- Anjeza Qoshja, emëruar në pozicionin “*Specialist për planifikim buxhetor*” në Sektorin e Financës, nëpërmjet aktit nr.141 (8529 prot.,) datë 31.10.2024 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Anxhela Lazaj, emëruar në pozicionin “*Specialist për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit, nëpërmjet aktit nr.52 (823 prot.,) datë 31.1.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Esterina Plaka, emëruar në pozicionin “*Specialiste IT dhe e Statistikave*”, në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit dhe Zyrës me një Ndalesë, nëpërmjet aktit nr.191 (8619 prot.,) datë 13.10.2025 “Për ndryshim pozicioni” të Kryetarit të Bashkisë.
- Borana Çela, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist, në “Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit”*” nëpërmjet aktit nr.10 (244 prot.,) datë 15.1.2025 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Marsela Çepele, emëruar në pozicionin “*Specialist i Sekretari-Arkivit*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike, nëpërmjet aktit nr.56 (3517 prot.,) datë 27.4.2022 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.
- Asim Hyska, emëruar në pozicionin “*Specialist Arkivist*” në “*Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore*” nëpërmjet aktit nr.3180, datë 15.4.2022 “Për emërim në detyrë përkohësisht” të Kryetarit të Bashkisë.

- Rabina Qamili, emëruar në pozicionin “*Specialist për dizenjim*” në Sektorin e Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, nëpërmjet aktit nr.186 (8454 prot.) datë 7.10.2025 “*Për emërim në detyrë përkohësisht*” të Kryetarit të Bashkisë.

6. Njësia përgjegjëse e institucionit, të hartojë një plan veprimi për zbatimin e këtij vendimi paralajmërues, i cili duhet të miratohet nga Kryetari i Bashkisë, ku të përcaktohen qartë: a) veprimet administrative që do të kryhen në zbatim të detyrave të lëna në raportin përfundimtar dhe në këtë vendim; b) subjekti/nëpunësi përgjegjës për kryerjen e veprimit; si dhe c) afati/data brenda të cilës do të përfundojë kryerja e veprimit administrativ. Në këtë akt do të parashikohet edhe radha e kryerjes së konkurrimeve për pozicionet e punës të cilat aktualisht janë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të evidentuara në pikën 5 të këtij vendimi.

Plani i veprimit do të dërgohet pranë Komisionerit 2 muaj, pas marrjes dijeni për këtë vendim paralajmërimi.

7. Nga ana e njësisë përgjegjëse dhe subjekteve të tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil për rregullimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, të korrigjohet baza ligjore e akteve të emërimit për nëpunësit D. Hoxha, V. Zeqo, A. Xhoka, E. Toro, E. Kocaqi, duke e vazhduar procesin me nxjerrjen e aktit të fillimit të marrëdhënieve financiare, të nëpunësve të lartpërmendur në respektim të pikës 41/2 të VKM-së nr. 242 datë 18.03.2025 “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, e ndryshuar.

8. Njësia Përgjegjëse e institucionit duhet të ngrejë Komitetin e Përhershëm të Pranimi, në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 22, të Ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

10. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Roskovec, Prefekti i Qarkut Fier, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Roskovec, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

- 11.** Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

Konceptoi: F. Doksani, A. Xhaxhiu, A. Kabali

Pranoi/Miratoi: A. Basha